

KONTRATE SHIT-BLERJE TE PJESEVE TE KAPITALIT THEMELTAR TE SHOQERISE

CLOVER HYDROPOWER SHPK

Sot me date 22/11/2021 (dy mije e njezet e nje) palet perpiluan kete kontrate shitje kuotash si me poshte vijon;

PALA SHITSE :

CLOVER shpk me NIUS: L82212021T dhe seli ne adresen KASHAR Rruga Dytesore Tirane Durres, km 6, godina nr.1 (QTU), dyqani nr.21, Kati I-re

PALA BLERESE :


Z. Robert Luku, i datelindjes 31/08/1976 lindur ne Durres dhe banuese ne Tirane me ID H608310310 me zotesi te plote juridike per te vepruar

OBJEKTI : Transferimi me ane te shitjes i 100% te pjeseve te kapitalit themeltar te Shoqerise "CLOVER HYDROPOWER" SH.P.K; kapital ne vleren 100.000 leke (njqind mije mije leke) nga shitesi CLOVER shpk tek blesesi Robert Luku

Me date 29/01/2021 eshte rregjistruar shoqeria CLOVER HYDROPOWER shpk me seli ne KASHAR Rruga Dytesore Tirane Durres, km 6, godina nr.1 (QTU), dyqani nr.21, Kati I-re me objekt aktiviteti: Operator i prodhimit, prodhim i energjise elektrike me venien ne perdorim te Hidrocentraleve ekzistues dhe me ndertimin e hidrocentraleve te rinj, te kapaciteteve te vegjel dhe te mesem (nga 0,2 - 2,5 MWA), transferim dhe shperndarje te energjise elektrike, ndertim-montim te impianteve te ndryshem elektrik te tensionit te ulet, te larte, etj.Rehabilitim ne parametrat e projektuar, i teresise fizike te objekteve, operim optimal tekniko-ekonomik per prodhimin e energjise elektrike, transferim shtetit, te teresise fizike dhe te aseteteve te rehabilituar te objekteve ne gjendje pune, rregjistruar ne QKB me Nipt M11329018K me status aktiv dhe kapital themeltar 100,000 (njqind mije) leke,

U vendos:

1. Miratimi per transferimin e 100% te pjeseve te kapitalit themeltar qe zoterohen nga ortaku **CLOVER shpk** tek ortaku **Robert Luku**
2. Transferimi i pjeseve te kapitalit behet me kontrate shitblerje dhe konsiderohet i perfunduar me permbushjen e plote te detyrimeve kontraktuale te paleve dhe depozitimim e kontrates se shitblerjes se ketyre pjeseve te kapitalit themeltar te shoqerise ne QKB:




Kushtet e kontrates:

1. Shitesi **CLOVER** eshte ortak i vetem i Shoqerise "CLOVER HYDROPOWER" shpk zoterues i 100% te pjeseve te kapitalit themeltar te kesaj shoqerise, te cilat do tia shese ortakut **Robert Luku**, ne vleren e tyre nominale, vlere e cila eshte shlyer plotesisht.
2. **Robert Luku** ka vendosur te bleje 100% te pjeseve te kapitalit themeltar te shoqerise "CLOVER HYDROPOWER" shpk qe zoteronte ortakun **CLOVER**
3. Shitesi i siguron bleresit se pjeset e kapitalit themeltar, objekt i kesaj kontrate jane te lira nga cdo pretendim apo e drejte e personave te trete ne castin e kalimit te pronesise se tyre tek bleresi, por pergjigjet edhe nese keto te meta shfaqen me pas.
4. Me nenshkrimin e kesaj kontrate, depozitimn e saj dhe te akteve qe lidhen me kete transferim te pjeseve te kapitalit themeltar te shoqerise ne QKB; shitesi **CLOVER** zhvishet nga cdo e drejte pronesie mbi 100% te pjeseve kapitalit themeltar te shoqerise "CLOVER YDROPOWER" shpk, objekt i kesaj kontrate dhe zoterues i tyre behet bleresi **Robert Luku**, duke u bere zoteruese e 100% te kapitalit themeltar te Shoqerise.
5. Kjo kontrate hyn ne fuqi menjehere me nenshkrimin e saj nga palet, te cilat nuk mund te ndrshojne kushtet e vendosura ne te me pelqimin e tyre.
6. Kjo kontrate eshte hartuar ne gjuhen shqipe, ne perputhje te plote me vullnetin e lire te paleve ne dy kopje te barazvlefshme.
7. Kontrata pasi u lexua me ze te larte, palet nenshkruan ate me vullnetin e tyre te lire sipas ligjit

PALA BLERESE

Robert Luku

Robert Luku



PALA SHITESE

CLOVER HYDROPOWER shpk

